**LIGJ**
**Nr. 59/2014**

# PËR KARRIERËN USHTARAKE NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

*(ndryshuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 64, datë 23.9.2015; me Ligjin nr. 15/2021, datë 8.2.2021 ; me ligjin nr. 9/2023, datë 2.2.2023 ; me ligjin nr. 37/2024, datë 18.4.2024 )*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

## KREU I
## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
**Objekti**

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i sistemit të menaxhimit të karrierës ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
**Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e kritereve për pranimin në Forcat e Armatosura, rendin e gradave, përparimin në gradë dhe karrierë, ndërprerjen e karrierës ushtarake, si dhe autoritetet përgjegjëse për zhvillimin e karrierës në Forcat e Armatosura.

Neni 3
**Subjektet**

Subjekte të këtij ligji janë ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, studentët ushtarakë, si dhe ushtarakët në rezervë.

Neni 4
**Juridiksioni territorial**

Ky ligj zbatohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë territorit të saj për ushtarakët shqiptarë kur ata janë dërguar me mision, shërbim, studime, stërvitje të përbashkëta, mision diplomatik ose në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare dy ose shumëpalëshe.

Neni 5
**Përkufizime**
*(shtuar pikat 13 e 14 me ligjin nr. 9/2023, datë 2.2.2023)*

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ushtarak aktiv i Forcave të Armatosura” është shtetasi shqiptar i titulluar oficer, nënoficer, ushtar nga autoriteti kompetent, që bën betimin ushtarak dhe shërben në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Forcat e Armatosura.

2. “Ushtarak në rezervë” është ushtaraku që ka shërbyer në Forcat e Armatosura dhe, pasi ndërpret karrierën ushtarake aktive, përfshihet në strukturat rezervë të Forcave të Armatosura.

3. “Ushtarak në lirim” është ushtaraku që ka shërbyer në Forcat e Armatosura dhe, pasi ndërpret karrierën ushtarake aktive, nuk përfshihet në strukturat rezervë të Forcave të Armatosura.

4. “Oficer aktiv i Forcave të Armatosura” është ushtaraku i titulluar si i tillë me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

5. “Nënoficer aktiv i Forcave të Armatosura” është ushtaraku i titulluar si i tillë me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

6. “Ushtar/detar aktiv i Forcave të Armatosura” është ushtaraku i titulluar si i tillë me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

7. “Student ushtarak” është shtetasi shqiptar që është përzgjedhur për t’u arsimuar në institucionet e përgatitjes së oficerëve të rinj, brenda ose jashtë vendit, dhe ka bërë betimin ushtarak.

8. “Kursant” është shtetasi shqiptar:

a) kandidat për oficer aktiv pas përfundimit minimalisht të ciklit të parë të studimeve të larta, brenda ose jashtë vendit, dhe që ndjek kursin përkatës ushtarak në institucionet arsimore ushtarake;

b) kandidat për ushtar, i cili është shpallur fitues pas procedurave të rekrutimit nga institucioni përkatës dhe ndjek kurset për t’u certifikuar për ushtar.

9. “Gradë ushtarake” është titulli dhe shenja që mban ushtaraku i Forcave të Armatosura në uniformën ushtarake.

10. “Gradë për specialitete” është kategoria e gradave ushtarake, e cila u jepet ushtarakëve të profesioneve specifike.

11. “Epror” është ushtaraku i cili, në bazë të gradës apo funksionit, ushtron autoritet mbi ushtarakët vartës.

12. “Vartës” është ushtaraku, i cili është nën autoritetin e një ushtaraku që ka gradë apo funksion më të lartë.

13. “Sportistë të nivelit të lartë” ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimeve të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, të ndryshuar;

14. “Gradë honorifike” është grada, e ndryshme nga gradat ushtarake të përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji, e cila i jepet sportistit të nivelit të lartë.

## KREU II
## GRADAT DHE KARRIERA USHTARAKE NË FORCAT E ARMATOSURA

### Neni 6
### **Karriera ushtarake**

Karriera ushtarake është ecuria në rendin e gradave dhe funksioneve gjatë kryerjes së shërbimit ushtarak aktiv.

### Neni 7
### **Hierarkia ushtarake**

1. Hierarkia ushtarake përfshin rendin e gradave dhe të funksioneve.

2. Rendi i gradave dhe i funksioneve në Forcat e Armatosura shkallëzohet nga më i ulëti në më të lartin, sipas lidhjeve e varësive që kanë ndërmjet tyre.

3. Ushtarakët, në varësi të hierarkisë së funksioneve dhe gradave, janë eprorë dhe vartës.

Neni 8

**Kategoritë e ushtarakëve**

1. Ushtarakët e Forcave të Armatosura janë ushtarakë të shërbimit aktiv dhe ushtarakë në rezervë.

2. Ushtarakët e shërbimit aktiv janë ushtarakë të shërbimit të përkohshëm dhe ushtarakë të shërbimit të karrierës. Ushtarakët e shërbimit të përkohshëm janë oficerët me gradë "Nëntoger", "Toger" dhe "Kapiten", nënoficerët me gradë "Nëntetar" e "Tetar" dhe ushtarët/detarët. Ushtarakë të shërbimit të karrierës janë oficerët me gradë "Major", "Nënkolonel", "Kolonel" dhe oficerët me gradë madhore dhe nënoficerët me gradë "Rreshter", "Kapter" dhe "Kryekapter".

3. Ushtarakë të shërbimit aktiv në Forcat e Armatosura janë oficerë, nënoficerë dhe ushtarë/detarë.

Neni 9

**Kontrata e shërbimit ushtarak aktiv**

*(ndryshuar nënndarja "i" e shkronjës "a", nënndarja "i" e shkronjës "b" , nënndarjet "i" dhe "ii" të shkronjës "c" të pikës 1 me ligjin nr. 15/2021, datë 8.2.2021)*

1. Ushtarakët, me pranimin e tyre në shërbimin ushtarak aktiv, nënshkruajnë kontratë, si më poshtë:

a) Për ushtarët/detarët:

i) kontrata lidhet për një afat jo më pak se 3 (tre) vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Kohëzgjatja e ripërtëritjes së kontratës nuk duhet të kalojë moshën maksimale të përcaktuar në nenet 14, pika 1, dhe 14/1 të këtij ligji;

ii) kontrata nënshkruhet midis ushtarakut dhe Forcave të Armatosura. Në emër të Forcave të Armatosura nënshkruajnë Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ose personi i autorizuar prej tij, komandanti i forcës, komandanti i strukturës mbështetëse apo komandantët e strukturave të tjera kryesore, në përputhje me strukturën e Forcave të Armatosura.

b) Për nënoficerët:

i) kontrata lidhet për një afat jo më pak se 3 (tre) vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Kohëzgjatja e ripërtëritjes së kontratës nuk duhet të kalojë moshën maksimale të përcaktuar në nenet 14, pika 1, dhe 14/1 të këtij ligji;

ii) kontrata nënshkruhet midis ushtarakut dhe Forcave të Armatosura. Në emër të Forcave të Armatosura nënshkruajnë Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ose personi i autorizuar prej tij, komandanti i forcës, komandanti i strukturës mbështetëse apo komandantët e strukturave të tjera kryesore, në përputhje me strukturën e Forcave të Armatosura.

c) Për studentët ushtarakë dhe oficerët:

i) kontrata lidhet me fillimin e studimeve brenda dhe jashtë vendit. Në kontratë përfshihen koha e arsimimit dhe 6 (gjashtë) vjet periudhë shërbimi nga data e emërimit të parë si oficer në Forcat e Armatosura. Kohëzgjatja e ripërtëritjes së kontratës nuk duhet të kalojë moshën maksimale të përcaktuar në nenet 14, pika 1, dhe 14/1 të këtij ligji;

ii) në emër të Forcave të Armatosura, për studentët ushtarakë nënshkruan komandanti i strukturës mbështetëse për çështje të arsimimit ushtarak, ndërsa për oficerët nënshkruan drejtuesi i njësisë së menaxhimit të personelit në Ministrinë e Mbrojtjes.

2. Në rast shkeljeje të kontratës, shtetasit dhe ushtarakët detyrohen të dëmshpërblejnë shpenzimet për kohën e studimit apo kualifikimit brenda ose jashtë vendit. Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes për shlyerjen e detyrimit në këto raste përbën titull ekzekutiv dhe për ekzekutimin e tij ngarkohet shërbimi përmbarimor

gjyqësor.

3. Procedurat e lidhjes së kontratës së shërbimit ushtarak aktiv përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Mbrojtjes.

4. Shtetasit/ushtarakët, që nënshkruajnë kontratë, sipas këtij neni, janë të detyruar të shërbejnë në të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura, sipas nevojave dhe situatave operacionale, brenda dhe jashtë vendit.

Neni 10

**Subjektet përfituese të gradave ushtarake**

Në Forcat e Armatosura gradat u jepen oficerëve, nënoficerëve, ushtarëve/detarëve, studentëve ushtarakë dhe ushtarakëve në rezervë.

Neni 11

**Klasifikimi i gradave ushtarake**

Gradat ushtarake në Forcat e Armatosura klasifikohen:

a) Për oficerët aktivë:

i) grada madhore;

ii) grada të larta;

iii) grada të ulëta.

b) Për nënoficerët aktivë:

i) grada të larta;

ii) grada të ulëta.

Neni 12

**Gradat ushtarake**

*(ndryshuar shkronja "ç" e pikës 1, shtuar pika 4 me ligjin nr. 15/2021, datë 8.2.2021, ndryshuar shkronja "ç" e pikës 1 dhe shtuar pika 5 me ligjin nr. 9/2023, datë 2.2.2023)*

1. Gradat ushtarake, sipas klasifikimit dhe shërbimit, janë:

a) Për oficerët aktivë:

| Klasifikimi | Grada Forca Tokësore/Ajrore | Grada Forca Detare |
|---|---|---|
| i)Gradë madhore | Gjeneral lejtnant | Admiral; |
| ii)Gradë madhore | Gjeneral major | Nënadmiral; |
| iii)Gradë madhore | Gjeneral brigade | Kundëradmiral; |
| iv)Gradëe lartë | Kolonel | Kapiten i rangut I; |
| v)Gradë e lartë | Nënkolonel | Kapiten i rangut II; |
| vi)Gradëe lartë | Major | Kapiten i rangut III; |
| vii)Gradëe ulët | Kapiten | Kapiten Lejtnant; |

| | | |
|---|---|---|
| viii)Gradëe ulët | Toger | Lejtnant; |
| ix)Gradë e ulët | Nëntoger | Nënlejtnant. |

b) Për nënoficerët aktivë:

| Klasifikimi | Grada Forca Tokësore/Ajrore | Grada Forca Detare |
|---|---|---|
| i) Gradë e lartë | Kryekapter | Kryekapter; |
| ii) Gradë e lartë | Kapter | Kapter; |
| iii) Gradë e ulët | Rreshter | Rreshter; |
| iv) Gradë e ulët | Tetar | Tetar; |
| v) Gradë e ulët | Nëntetar | Nëntetar |

c) Për ushtarët aktivë:

| Titulli | Grada Forca Tokësore/Ajrore | Grada Forca Detare |
|---|---|---|
| i) Ushtar | Ushtar IV | Detar IV; |
| ii) Ushtar | Ushtar III | Detar III; |
| iii) Ushtar | Ushtar II | Detar II; |
| iv) Ushtar | Ushtar I | Detar I. |

ç) Për studentët:

| Titulli | Lloji i gradës |
|---|---|
| Student ushtarak | Kadet |

2. Studentët shqiptarë, që ndjekin studimet në shkollat ushtarake jashtë vendit, mbajnë uniformën dhe simbolet e gradës së studentit të akademive ushtarake shqiptare, sipas marrëveshjeve dypalëshe me vendet pritëse.

3. Rekrutët, kur hyjnë në shërbimin aktiv, nuk mbajnë gradë deri në përfundimin me sukses të stërvitjes bazë. Pas përfundimit të kësaj periudhe, kandidatët për ushtarë gradohen "Ushtar I" ose "Detar I".

4. Ushtarët dhe nënoficerët, që konkurrojnë për shkolla të larta ushtarake brenda vendit, ruajnë gradën që mbajnë në momentin e pranimit në shkollat e larta ushtarake deri në përfundim të studimeve.

5. Grada "Kadet" për efekt të pagesës njësohet me gradën "Ushtar I".

Neni 12/1

**Grada honorifike**

*(shtuar me ligjin nr. 9/2023, datë 2.2.2023)*

1. Sportistit të nivelit të lartë i jepet grada honorifike me urdhër të ministrit të Mbrojtjes.

2. Propozimi për dhënien e gradës honorifike bëhet nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm pas vlerësimit nga Komisioni i Gradave Honorifike.

3. Grada honorifike njësohet me gradën e ushtarakut aktiv vetëm për efekt trajtimi me pagë.

4. Sportisti i nivelit të lartë mban gradën honorifike sipas përcaktimeve të nenit 14 të këtij ligji.

5. Grada honorifike u jepet sportistëve, të cilët kanë arritur një nga rezultatet e përcaktuara në nenin 12/2 të këtij ligji dhe praktikojnë sportin sipas përcaktimeve të ligjit nr. 79/2017, "Për sportin", të ndryshuar.

6. Sportisti i nivelit të lartë del në lirim me mbushjen e moshës maksimale të qëndrimit në shërbimin aktiv sipas pikës 1 të nenit 14 të këtij ligji, ose me plotësimin e njërit prej kritereve të përcaktuara në shkronjat "a", "b" dhe "ç" të pikës 1 të nenit 26 të këtij ligji ose me kryerjen e sjelljeve në kundërshtim

me parimet e përgjithshme të etikës sportive. Me daljen në lirim, sportisti i nivelit të lartë ndërpret marrëdhëniet financiare me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, me propozim të shefit të Shtabit të Përgjithshëm.

7. Në rastet kur sportisti i nivelit të lartë, mbajtës i njërës prej gradave honorifike, arrin një rezultat më të lartë, sipas të cilit merret një gradë honorifike më e lartë, me propozim të shefit të Shtabit të Përgjithshëm, me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, i jepet grada honorifike më e lartë.

Neni 12/2

**Klasifikimi i gradave honorifike**

*(shtuar me ligjin nr. 9/2023, datë 2.2.2023)*

Gradat honorifike, sipas rezultateve si sportist i nivelit të lartë, janë:

| **Rezultati** | **Grada** |
|---|---|
| a) sportisti, i cili thyen rekord olimpik/botëror/evropian | Kolonel; |
| b) vendi i parë deri në vendin e tretë në lojërat olimpike/<br>kampionat botëror | Kolonel; |
| c) vendi i parë në kampionatin evropian | Kolonel; |
| ç) vendi i dytë deri në vendin e tretë në kampionatin evropian | Nënkolonel; |
| d) vendi i katërt deri në vendin e gjashtë në lojërat olimpike | Nënkolonel; |
| dh) vendi i shtatë deri në vendin e tetë në lojërat olimpike | Major; |
| e) vendi i katërt deri në vendin e gjashtë në kampionate botërore | Major; |
| ë) vendi i parë në lojërat mesdhetare | Major. |

Neni 12/3

*(shtuar me ligjin nr. 9/2023, datë 2.2.2023)*

Ministria e Mbrojtjes mbështet iniciativat për krijimin dhe funksionimin e shoqatave sportive në Forcat e Armatosura. Krijimi, organizimi dhe regjistrimi i tyre bëhen sipas legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse.

Neni 13

**Koha e qëndrimit në gradë**

*(ndryshuar shkronja "ç" e pikës 1, shfuqizuar pika 2 me ligjin nr. 15/2021, datë 8.2.2021)*

1. Koha minimale e qëndrimit në një gradë për fitimin e gradës së radhës është:

| Forca Tokësore/Ajrore | Forca Detare | Koha në gradë |
|---|---|---|
| a) Ushtar I | Detar I | 1 vit; |
| b) Ushtar II | Detar II | 1 vit; |
| c) Ushtar III | Detar III | 1 vit; |
| ç) Ushtar IV | Detar IV | 2 vjet; |
| d) Nëntetar | Nëntetar | 3 vjet; |
| dh) Tetar | Tetar | 4 vjet; |

| | | |
|---|---|---|
| e) Rreshter | Rreshter | 6 vjet; |
| ë) Kapter | Kapter | 5 vjet; |
| f) Nëntoger | Nënlejtnant | 3 vjet; |
| g) Toger | Lejtnant | 4 vjet; |
| gj) Kapiten | Kapiten lejtnant | 5 vjet; |
| h) Major | Kapiten i rangut III | 6 vjet; |
| i) Nënkolonel | Kapiten i rangut II | 5 vjet; |
| j) Kolonel | Kapiten i rangut I | 5 vjet; |
| k) Gjeneral brigade | Kundëradmiral | 3 vjet; |
| l) Gjeneral major | Nënadmiral | 3 vjet. |

2. Shfuqizuar.

3. Koha e qëndrimit në një gradë në shërbimin aktiv llogaritet nga data e hyrjes në fuqi të urdhrit përkatës për dhënien e gradës.

4. Koha e shërbimit në rezervë nuk llogaritet si kohë qëndrimi në gradë për gradim në shërbimin aktiv.

5. Kriteret për gradimin e oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve në rezervë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

Neni 14

**Mosha maksimale e qëndrimit në shërbimin aktiv**

*(ndryshuar shkronjat "g" e "gj" të pikës 1 me ligjin nr. 15/2021, datë 8.2.2021; ndryshuar shkronjat "a" deri në "ë" dhe "g" deri në "j" të pikës 1 dhe pika 5 me ligjin nr. 37/2024, datë 18.4.2024)*

1. Mosha maksimale e qëndrimit në shërbimin aktiv është:

| Forca Tokësore /Ajrore | Forca Detare | Mosha në shërbim aktiv |
|---|---|---|
| a) Ushtar I | Detar I | 31 vjeç; |
| b) Ushtar II | Detar II | 32 vjeç; |
| c) Ushtar III | Detar III | 33 vjeç; |
| ç) Ushtar IV | Detar IV | 36 vjeç; |
| d) Nëntetar | Nëntetar | 40 vjeç; |
| dh) Tetar | Tetar | 48 vjeç; |
| e) Rreshter | Rreshter | 55 vjeç; |
| ë) Kapter | Kapter | 56 vjeç; |
| f) Kryekapter | Kryekapter | 57 vjeç; |
| g) Nëntoger | Nënlejtënant | 36 vjeç; |
| gj) Toger | Lejtënant | 41 vjeç |
| h) Kapiten | Kapitenlejtënant | 48 vjeç; |
| i) Major | Kapiten i rangut të tretë | 57 vjeç; |
| j) Nënkolonel | Kapiten i rangut të dytë | 58 vjeç.". |
| k) Kolonel | Kapiten i rangut I | 59 vjeç; |
| l) Gjeneral brigade | Kundëradmiral | 61 vjeç; |
| ll) Gjeneral major | Nënadmiral | 63 vjeç; |
| m) Gjeneral lejtnant | Admiral | 65 vjeç. |

2. Oficeri me gradë madhore, pavarësisht nga mosplotësimi i moshës së përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, dhe i kritereve të përcaktuara në nenet 25 dhe 26, të këtij ligji, nxirret në rezervë apo lirim, kur plotëson njërin nga këto kritere:

a) kur pas kalimit të kohës së qëndrimit në një gradë sipas pikës 1, të nenit 13, të këtij ligji, nuk ka marrë gradën e radhës;

b) kur nuk ka kuota të lira për konkurrim për gradën e radhës, sipas tabelës së organizimit dhe pajisjeve.

3. Oficerët, pas marrjes së gradës "Major" dhe nënoficerët pas marrjes së gradës "Rreshter", nuk nënshkruajnë kontratë, por vazhdojnë shërbimin aktiv të karrierës dhe shërbejnë në shërbimin aktiv, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni.

4. Mosha minimale e pranimit në Forcat e Armatosura është 18 vjeç.

5. Shtetasit, në momentin e titullimit oficer aktiv dhe ushtar/detar aktiv, nuk duhet të kenë mbushur moshën 30 vjeç. Përjashtim bëjnë vetëm shtetasit që do të titullohen oficerë dhe ushtarë/detarë aktivë, të cilët do të jenë personel mjekësor, i Orkestrës Frymore dhe Orkestrës Simfonike të Forcave të Armatosura, të cilët në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç.

Neni 14/1

**Mosha maksimale e qëndrimit në shërbimin aktiv për specialitetet**

*(shtuar me ligjin nr. 15/2021, datë 8.2.2021)*

1. Mosha maksimale e qëndrimit në shërbim aktiv për specialitetet është:

| **Forca tokësore/ajrore** | **Forca detare** | **Mosha në shërbim aktiv** |
|---|---|---|
| a) Ushtar IV | Detar IV | 42 vjeç; |
| b) Nëntetar | Nëntetar | 45 vjeç |
| c) Tetar | Tetar | 50 vjeç; |
| ç) Rreshter | Rreshte | 57 vjeç; |
| d) Kapter | Kapter | 58 vjeç; |
| dh)Nëntoger | Nënlejtënant | 41 vjeç |
| e)Toger | Lejtënant | 45 vjeç; |
| ë)Kapiten | Kapiten lejtënant | 51 vjeç; |
| f)Major | Kapiten i rangut të tretë | 60 vjeç; |
| g) Nënkolonel | Kapiten i rangut të dytë | 61 vjeç. |

Neni 14/2

**Mosha minimale e konkurrimit për marrjen e gradës**

*(shtuar me ligjin nr. 15/2021, datë 8.2.2021)*

Mosha minimale për konkurrim për marrjen e gradave të larta dhe gradës "Gjeneral brigade/Kundëradmiral" është si më poshtë:

| **Forca tokësore/ajrore** | **Forca detare** | **Mosha në shërbim aktiv** |
|---|---|---|
| a) Kapiten | Kapiten lejtënant | 34 vjeç; |
| b) Major | Kapiten i rangut të tretë | 40 vjeç; |
| c) Nënkolonel | Kapiten i rangut të dytë | 45 vjeç; |
| ç) Kolonel | Kapiten i rangut të parë | 50 vjeç.". |

KREU III

TITULLIMI DHE GRADIMI I USHTARAKËVE AKTIVË

Neni 15

**Titullimi dhe gradimi i ushtarëve aktivë**

*(ndryshuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 15/2021, datë 8.2.2021)*

1. "Ushtar/detar aktiv i Forcave të Armatosura" titullohet shtetasi shqiptar që ka kryer minimalisht arsimin "9-vjeçar" brenda ose jashtë vendit, ka kryer kursin përkatës ushtarak të ushtarit dhe bën betimin ushtarak.

2. Titullimi "Ushtar/detar aktiv" dhe dhënia e gradës së parë të ushtarit/detarit aktiv bëhet me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, me propozimin e titullarit të institucionit arsimor dhe stërvitor në Forcat e Armatosura, i cili ka certifikuar kandidatin në përfundim të kursit.

Shtetasit shqiptar, kandidat për "Ushtar/detar aktiv", me arsim të lartë, i jepet grada "Ushtar II/detar II".

3. Gradat e tjera për ushtarët/detarët aktivë jepen nga:

a) Shefi i Shtabit të Përgjithshëm për ushtarët/detarët që shërbejnë në Ministrinë e Mbrojtjes, Shtabin e Përgjithshëm dhe strukturat e varësisë së tyre;

b) komandanti i forcës për strukturën që drejton dhe ato të varësisë;

c) komandanti i strukturës mbështetëse për strukturën që drejton dhe ato të varësisë.

4. Ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, përcakton me udhëzim procedurat dhe kriteret për rekrutimin e ushtarëve/detarëve aktivë.

Neni 16

**Titullimi dhe gradimi i nënoficerëve aktivë**

*(shtuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 15/2021, datë 8.2.2021)*

1. "Nënoficer aktiv" titullohet ushtari/detari IV, që ka kryer minimalisht arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit dhe kualifikimin përkatës të nënoficerit.

2. Titullimi "nënoficer aktiv" dhe dhënia e gradës së parë "Nëntetar" bëhet me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, me propozimin e titullarit të institucionit arsimor dhe stërvitor në Forcat e Armatosura, i cili ka certifikuar kandidatin në përfundim të kursit.

3. Gradat për nënoficerët aktivë jepen me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, me propozimin e komisionit të karrierës.

4. Ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, përcakton me udhëzim procedurat dhe kriteret për rekrutimin e nënoficerëve aktivë.

Neni 17

**Titullimi dhe gradimi i oficerëve aktivë**

*(shtuar pika 7 me Ligjin nr. 37/2024, datë 18.4.2024)*

1. "Oficer aktiv i Forcave të Armatosura" titullohet shtetasi shqiptar që plotëson një nga kriteret e mëposhtme dhe bën betimin ushtarak:

a) të ketë kryer arsimin e lartë ushtarak brenda ose jashtë vendit;

b) të ketë kryer arsimin e lartë ushtarak dhe ciklin e parë të studimeve të larta pas arsimimit ushtarak jashtë vendit;

c) të ketë kryer ciklin e parë të studimeve të larta, brenda ose jashtë vendit, dhe kursin përkatës ushtarak në institucionet arsimore ushtarake.

2. Titullimi "oficer aktiv" dhe dhënia e gradës së parë të oficerit bëhet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e titullarit të institucionit arsimor dhe stërvitor në Forcat e Armatosura.

3. Grada "Nëntoger" u jepet shtetasve që janë titulluar "oficer aktiv".

4. Gradat e ulëta dhe të larta të oficerëve jepen me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e komisioneve të karrierës.

5. Gradat madhore u jepen oficerëve me dekret të Presidentit të Republikës, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

6. Grada e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm dhe Grada e Komandantit të Forcave të Armatosura në kohë lufte jepen me dekret të Presidentit të Republikës, me propozimin e Kryeministrit.

7. Ushtaraku me gradë madhore, i cili emërohet në detyrën e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, merr gradën e njësuar sipas funksionit të përcaktuar në tabelën e organizimit e të pajisjeve në Forcat e Armatosura.

Neni 18

**Kriteret e përgjithshme për përparimin në gradë**

*(ndryshuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 15/2021, datë 8.2.2021)*

1. Ushtaraku merret në shqyrtim për marrjen e gradës së radhës, kur plotëson kriteret e mëposhtme:

a) të ketë plotësuar kohën e qëndrimit në një gradë, sipas pikës 1, të nenit 13, të këtij ligji;

b) të ketë arsimimin dhe kualifikimin e nevojshëm për marrjen e gradës së radhës, sipas nenit 20 të këtij ligji;

c) më shumë se gjysma e vlerësimeve vjetore gjatë viteve të qëndrimit në gradën që mban të mos jetë më e ulët se "kënaqshëm";

ç) të jetë i aftë fizikisht dhe në gjendje shëndetësore të mirë.

2. Nënoficerët me gradë "Nëntetar" dhe oficerët me gradë "Nëntoger", "Toger", shqyrtohen tre herë radhazi nga komisionet e karrierës për marrjen e gradës së radhës.

3. Nënoficerët me gradë "Tetar" dhe oficerët me gradë "Kapiten" shqyrtohen tri herë radhazi nga komisionet e karrierës për marrjen e gradës së radhës.

4. Oficerët e karrierës me gradë "Major", "Nënkolonel", "Kolonel" dhe nënoficerët e karrierës me gradë "Rreshter" dhe "Kapter" shqyrtohen tri herë radhazi nga komisionet e karrierës për marrjen e gradës së radhës.

5. Oficerët me gradë madhore shqyrtohen vetëm një herë nga komisioni i karrierës për marrjen e gradës se radhës.

6. Gradimi, sipas këtij ligji, bëhet në përputhje me nevojat organike të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

7. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, brenda muajit mars të çdo viti, i paraqet Ministrit të Mbrojtjes nevojat organike të Forcave të Armatosura për çdo gradë, sipas llojit të forcës dhe specialiteteve. Komandantët e forcave dhe komandantët e strukturave mbështetëse, brenda muajit mars të çdo viti, i paraqesin Shefit të Shtabit të Përgjithshëm nevojat organike të strukturave që drejtojnë për çdo gradë, sipas llojit të forcës dhe specialiteteve.

8. Ministri i Mbrojtjes, në zbatim të shkronjës "ç", të pikës 1, të këtij neni, miraton rregulloren e aftësive fizike, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm.

Neni 18/1

*(shtuar me Ligjin nr. 37/2024, datë 18.4.2024)*

1. Gradimi i parakohshëm i ushtarakëve për gradën e radhës mund të bëhet vetëm një herë gjatë karrierës ushtarake, jo më parë se një vit nga plotësimi i afatit kohor të qëndrimit në gradë.

2. Përjashtohen nga përcaktimi i këtij neni ushtarakët aktivë nënoficerë me gradën "kapter", oficerët aktivë me gradën "kolonel" dhe ushtarakët me gradë madhore.

3. Kriteret dhe mënyra e vlerësimit të ushtarakëve, sipas këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, në përputhje me nevojat organike të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 19
**Vlerësimi vjetor i ushtarakut**

1. Vlerësimi vjetor i ushtarakut është procesi i verifikimit të përgjithshëm vjetor të realizimit të objektivave të përcaktuar në detyrë, i aftësive apo dobësive të ushtarakut në kryerjen e detyrave, si dhe cilësive etike e morale të tij. Vlerësimi i rezultateve synon përmirësimin e aftësive profesionale dhe të cilësisë së shërbimit nga ushtarakët.

2. Ushtaraku vlerësohet në një nga këto nivele:

a) “Shkëlqyer”;
b) “Shumë mirë”;
c) “Kënaqshëm”;
ç) “Jo gjithnjë i përshtatshëm”;
d) “Pamjaftueshëm”.

3. Ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, miraton rregulloren e vlerësimit të ushtarakëve.

Neni 20
**Arsimimi dhe kualifikimi për përparim në gradë**
*(ndryshuar me ligjin nr. 15/2021, datë 8.2.2021)*

Ushtarakët e Forcave të Armatosura për të fituar gradën e radhës duhet të plotësojnë kriteret e arsimimit e të kualifikimit, të përcaktuara në politikën e arsimimit të Forcave të Armatosura, të miratuar me urdhër të ministrit të Mbrojtjes e me propozim të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Neni 21
**Kriteret e përparimit në gradë për specialitetet**
*(ndryshuar pika 1, shtuar pika 1/1 me ligjin nr. 15/2021, datë 8.2.2021)*

1. Përparimi në gradë për oficerët deri në gradën “nënkolonel/kapiten i rangut të dytë”, nënoficerët deri në gradën “kapter” dhe ushtarët deri në gradën “ushtar IV”, që kryejnë detyra organike në specialitete në Forcat e Armatosura, bëhet sipas kritereve të përcaktuara në nenet 13 e 14/1 të këtij ligji dhe në përputhje me nevojat organike të Forcave të Armatosura.

1/1. Specialitetet, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit të Mbrojtjes.

2. Specifika e këtyre gradave bëhet e dallueshme nëpërmjet dizenjimit të veçantë të tyre.

3. Gradat e përfituara sipas këtij neni ruajnë vlerën juridike vetëm kur mbajtësit e tyre ushtrojnë funksione në specialitetin që është bërë parakusht për marrjen e gradës. Kur ushtaraku nuk ushtron detyrën sipas specialitetit të tij, mban të njëjtën gradë.

4. Ushtarakët e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, përfitojnë grada të tjera ushtarake të sistemit të karrierës, kur plotësojnë kriteret e tjera të këtij ligji për gradën respektive.

5. Numri i përgjithshëm i personelit, që mban grada për specialitetet, përcaktohet nga Ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm. Përcaktimi i numrit të personelit që mban grada për specialitete bëhet duke marrë parasysh misionin dhe detyrat e strukturave të Forcave të

Armatosura.

Neni 22
**Komisionet e karrierës**
*(shtuar paragraf në shkronjën "b" të pikës 3 pas nënndarjes "iii" me ligjin nr. 15/2021, datë 8.2.2021: ndryshuar shkronjat "b" dhe "c" të pikës 2 dhe pika 5, shfuqizuar shkronja "ç" e pikës 2 dhe 3, shtuar paragrafë në pikën 3 me Ligjin nr. 37/2024, datë 18.4.2024)*

1. Komisionet e karrierës janë autoritetet përgjegjëse për vlerësimin e përparimit të ushtarakëve në gradë, si dhe për kualifikimet që shërbejnë për marrjen e gradës së radhës.

2. Komisionet e karrierës janë:

a) komisioni i veçantë, i cili vlerëson oficerët për marrjen e gradave madhore;

b) Komisioni i lartë, i cili vlerëson oficerët për marrjen e gradave "major/kapiten i rangut të tretë", "nënkolonel/kapiten i rangut të dytë" dhe "kolonel/kapiten i rangut të parë" dhe nënoficerët për marrjen e gradave "kapter dhe kryekapter", si dhe personelin oficer për kualifikim nga grada "kapiten" deri në gradën "nënkolonel" dhe personelin nënoficer me gradën "rreshter" dhe "kapter", të cilët përmbushin kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

c) Komisioni i zakonshëm vlerëson oficerët për marrjen e gradave "toger/lejtënant" dhe "kapiten/kapitenlejtënant", si dhe personelin nënoficer "tetar" dhe "rreshter", si dhe personelin nënoficer për kualifikim nga grada "nëntoger/nënlejtënant" deri në gradën "toger/lejtënant" dhe personelin nënoficer me gradën "nëntetar" deri në gradën "tetar", të cilët përmbushin kriteret e përcaktuara në këtë ligj. Komisioni i zakonshëm ngrihet përkatësisht në komandat e forcave, në Akademinë e Forcave të Armatosura, në Komandën Mbështetëse dhe në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për repartet e varësisë së drejtpërdrejtë dhe ato të Ministrisë së Mbrojtjes;

ç) *Shfuqizuar.*

3. Përbërja e komisioneve të karrierës:

a) Komisioni i veçantë përbëhet nga:

| | |
|---|---|
| i) Shefi i Shtabit të Përgjithshëm | kryetar; |
| ii) dy gjeneralë majorë/nënadmiralë | anëtarë; |
| iii) dy gjeneralë brigade/kundëradmiralë | anëtarë. |

b) Komisioni i lartë përbëhet nga:

| | |
|---|---|
| i) një gjeneral major/nënadmiral | kryetar; |
| ii) tre gjeneralë brigade/kundëradmiralë | anëtarë; |
| iii) tre kolonelë/kapitenë të rangut I | anëtarë. |

Në rast mungese organike të oficerëve me gradën madhore "gjeneralmajor/nënadmiral", ata zëvendësohen me oficerë me gradën madhore "gjeneral brigade/kundëradmiral.

Në rastet kur shqyrtohen oficerë dhe nënoficerë të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në komision marrin pjesë respektivisht edhe dy kolonelë kur shqyrtohen oficerët dhe dy kryekapterë kur shqyrtohen nënoficerët nga kjo Agjenci, me të drejtë vote.

Në rastet kur shqyrtohen nënoficerët e forcave dhe strukturave mbështetëse për marrjen e gradës kryekapter, në komision marrin pjesë edhe dy kryekapterë, me të drejtë vote.

Komisioni i lartë mblidhet sipas afateve të përcaktuara në urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes;

c) Komisioni i zakonshëm për oficerët dhe nënoficerët me grada të ulëta përbëhet nga:

| | |
|---|---|
| i) një gjeneral brigade/kundëradmiral | kryetar; |
| ii) gjashtë kolonelë/kapitenë të rangut I | anëtarë. |

Në rast mungese organike të oficerëve me gradën madhore "gjeneral brigade/kundëradmiral", ata zëvendësohen me oficerë me gradën "kolonel/kapiten i rangut të parë" dhe në rast mungese organike

të oficerëve me gradën “kolonel/kapiten i rangut të parë”, ata zëvendësohen me oficerë me gradën “nënkolonel/kapiten i rangut të dytë.

Komisioni i zakonshëm ngrihet me urdhër të ministrit të Mbrojtjes për të vlerësuar dhe për të propozuar për gradim e kualifikim oficerët me gradën “nëntoger/nënlejtënant, “toger/lejtënant” dhe nënoficerët me gradën “nëntetar”, “tetar” dhe “rreshter”, të cilët përmbushin kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

Në rastet kur shqyrtohen oficerë të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në komision marrin pjesë edhe dy kolonelë nga kjo Agjenci, me të drejtë vote.

Komisioni i zakonshëm për oficerët me grada të ulëta mblidhet sipas afateve të përcaktuara në urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes.

ç) *Shfuqizuar.*

4. Nuk bëjnë pjesë në komisionet e karrierës:

a) anëtarët e kabinetit të Ministrit të Mbrojtjes;

b) ushtarakët e shërbimeve inteligjente dhe informative, me përjashtim të rasteve të parashikuara në shkronjat “b”, “c”, të pikës 3, të këtij neni.

5. Komisionet e karrierës, me përjashtim të komisionit të veçantë, i përfundojnë procedurat e punës së tyre brenda:

a) muajit qershor të çdo viti nga komisionet përgjegjëse për vlerësimin e ushtarakëve për kualifikimet që shërbejnë për marrjen e gradës së radhës;

b) muajit tetor të çdo viti nga komisionet përgjegjëse për vlerësimin e përparimit në gradë të ushtarakëve.

6. Komisionet e karrierës ngrihen me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm.

7. Funksionimi, procedurat e punës, mënyra e vlerësimit të ushtarakëve, gjatë procedurave për vlerësimin e përparimit të ushtarakëve në gradë, si dhe për kualifikimet përcaktohen me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm.

8. Përjashtim nga sistemi i vlerësimit me pikë bëhet për marrjen e gradave gjeneral major/nënadmiral dhe gjeneral lejtnant/admiral, të cilat vlerësohen në bazë të meritave, përgatitjes dhe aftësive profesionale.

Neni 22/1

**Komisioni i Gradave Honorifike**

*(shtuar me ligjin nr. 9/2023, datë 2.2.2023)*

1. Komisioni i Gradave Honorifike është autoriteti përgjegjës për vlerësimin e sportistëve për marrjen e gradave honorifike. Komisioni ngrihet me urdhër të ministrit të Mbrojtjes sa herë vlerësohet e nevojshme.

2. Përbërja e Komisionit të Gradave Honorifike përbëhet nga:

a) drejtori i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;

b) dy kolonelë;

c) dy përfaqësues nga ministria përgjegjëse për sportin.

3. Funksionimi, procedurat dhe afatet për kryerjen e vlerësimit përcaktohen me urdhër të ministrit të Mbrojtjes.

Neni 23

**Njësimi i gradave me funksionet organike**

Njësimi i gradave me funksionet organike në Forcat e Armatosura përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

Neni 24

**Pezullimi i ushtarakëve nga detyra**

*(ndryshuar fjalia e dytë e pikës 1, shkronja "c" e pikës 2 me ligjin nr. 15/2021, datë 8.2.2021)*

1. Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënieve të punës për periudhën sa zgjat arsyeja e ndërprerjes. Në mbarim të kësaj periudhe, ushtaraku emërohet në përputhje me gradën që mban, me përjashtim të rastit kur plotëson kushtet për daljen në lirim sipas shkronjës "b" të nenit 26 të këtij ligji.

2. Ushtaraku pezullohet:

a) kur ndaj tij fillon ndjekja penale dhe vendoset masa e sigurisë arrest në burg ose arrest në shtëpi, deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë nga gjykata ose kur ndaj tij fillon procedimi penal për vepra penale që lidhen me detyrën;

b) për periudha studimi më shumë se 6 muaj, të ndërmarra me nismën e vetë ushtarakut dhe në lidhje me profesionin që ai ushtron;

c) me kërkesën e ushtarakut për të shoqëruar bashkëshortin/bashkëshorten, që emërohet jashtë shtetit në funksione zyrtare ose që dërgohet në trajnime/kualifikime afatgjata mbi 9 (nëntë) muaj jashtë vendit. Në këtë rast, pezullimi zgjat sa periudha e emërimit ose trajnimit/kualifikimit, por jo më shumë se 4 (katër) vjet.

3. Gjatë periudhës së pezullimit, ushtaraku nuk paguhet. Në rastin e parashikuar në shkronjën "a", të pikës 2, të këtij neni, kur çështja penale pushohet ose kur me vendim gjykate të formës së prerë ushtaraku deklarohet i pafajshëm, ai emërohet në detyrë, i jepet paga bazë me të gjitha përfitimet e tjera që nga çasti i pezullimit.

4. Periudha e kohës së pezullimit nga detyra njihet si vjetërsi grade dhe shërbimi në Forcat e Armatosura, kur pezullimi ndodh për rastin e parashikuar në shkronjën "a", të pikës 2, të këtij neni, dhe çështja penale pushohet ose kur me vendim gjykate të formës së prerë ushtaraku deklarohet i pafajshëm, ndërsa për rastet e parashikuara në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 2, të këtij neni, periudha e pezullimit njihet vetëm për efekt të vjetërsisë së gradës.

5. Pezullimi i oficerit nga detyra bëhet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, ndërsa pezullimi i nënoficerit dhe ushtarit/detarit bëhet me urdhër të autoritetit që ka kompetencën e emërimit.

Neni 25

**Dalja në rezervë e ushtarakëve**

*(shfuqizuar pika 3 me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 64, datë 23.9.2015, ndryshuar shkronja "b" e pikës 1, shfuqizuar shkronja "c" e pikës 1 me ligjin nr. 15/2021, datë 8.2.2021)*

1. Ushtaraku del në rezervë nga shërbimi aktiv kur ka plotësuar njërin nga kushtet e mëposhtme:

a) ka plotësuar afatin e parashikuar në kontratë;

b pavarësisht numrit të aplikimeve për marrjen e gradës së radhës, ka plotësuar moshën maksimale të qëndrimit në shërbim, përcaktuar në nenin 14 të këtij ligji;

c) shfuqizuar;

ç) ka dy vlerësime vjetore "pamjaftueshëm" gjatë kohës së qëndrimit në një gradë;

d) paraqet kërkesën dhe ajo miratohet nga organi përgjegjës. Organi përgjegjës kthen përgjigje brenda tre muajve. Në rast se organi përgjegjës nuk kthen përgjigje brenda këtij afati, kërkesa quhet e miratuar.

dh) kur bëhen shkurtime në numrin e përgjithshëm të personelit të Forcave të Armatosura. Në këtë rast, kriteret e përzgjedhjes së ushtarakëve që dalin në rezervë përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Mbrojtjes, sipas propozimit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

2. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm del në rezervë me dekret të Presidentit të Republikës, me propozimin e Kryeministrit.

3. Shfuqizuar.

4. Oficerët, përveç atyre që mbajnë grada madhore, dalin në rezervë me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm.

5. Nënoficerët dalin në rezervë me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, me propozimin e komandantit të forcës ose komandantit të strukturës mbështetëse.

6. Ushtarët/detarët dalin në rezervë me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, me propozimin e komandantit të forcës ose komandantit të strukturës mbështetëse.

Neni 26

**Dalja në lirim e ushtarakëve**

*(shfuqizuar pika 4 me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 64, datë 23.9.2015, ndryshuar shkronja "b" e pikës 1 me ligjin nr. 15/2021, datë 8.2.2021, ndryshuar fjalë nështkronjën "b" të pikës 1 me ligjin nr. 9/2023, datë 2.2.2023)*

1. Ushtaraku del në lirim nga shërbimi aktiv kur ka plotësuar njërin nga kushtet e mëposhtme:

a) ka plotësuar moshën për pension pleqërie;

b) vuan dënim me burgim me vendim gjyqësor të formës së prerë ose dënohet me vendim të formës së prerë për një krim të kryer me dashje apo vepër penale të kryer me pakujdesi, e cila cenon figurën dhe integritetin e Forcave të Armatosura;

c) shpallet i paaftë nga ana shëndetësore për shërbim ushtarak me vendim të komisionit përkatës mjekësor;

ç) paraqet kërkesën dhe ajo miratohet nga organi përgjegjës. Organi përgjegjës kthen përgjigje brenda tre muajve. Në rast se organi përgjegjës nuk kthen përgjigje brenda këtij afati, kërkesa quhet e miratuar;

d) ka kryer shkelje shumë të rënda disiplinore, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë;

dh) në rastet e parashikuara në pikën 1, të nenit 25, të këtij ligji, kur është mbi moshën e shërbimit ushtarak në rezervë, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë.

2. Në rastet e parashikuara në shkronjat "b" dhe "d", të pikës 1, të këtij neni, ushtaraku shkarkohet nga detyra dhe del në lirim.

3. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm del në lirim me dekret të Presidentit të Republikës, me propozimin e Kryeministrit.

4. Shfuqizuar.

5. Oficerët, përveç atyre që mbajnë grada madhore, dalin në lirim me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm.

6. Nënoficerët dalin në lirim me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, me propozimin e komandantit të forcës ose komandantit të strukturës mbështetëse.

7. Ushtarët/detarët dalin në lirim me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, me propozimin e komandantit të forcës ose komandantit të strukturës mbështetëse.

Neni 27

**Periudha e qëndrimit të ushtarakut në dispozicion**

*(shtuar fjalë në fjalinë e dytë të pikes 2 me ligjin nr. 9/2023, datë 2.2.2023*

1. Kur ushtaraku lirohet nga detyra, ai emërohet menjëherë në një detyrë tjetër, në përputhje me

arsimimin, specialitetin dhe funksionet organike sipas gradës që mban.

2. Në raste të veçanta, emërimi në një detyrë tjetër bëhet brenda një periudhe 2-mujore. Gjatë kësaj periudhe dhe deri në emërimin në detyrë, ushtaraku i liruar nga detyra paguhet me pagën mujore të gradës që mban, por jo më shumë se dy muaj.

Neni 28

**Ankimi për procedurën e vlerësimit të komisioneve të karrierës**

1. Ushtarakët, që janë marrë në shqyrtim për gradën e radhës, mund të ankohen për vlerësimin e komisionit të karrierës te Ministri i Mbrojtjes. Ankimet bëhen brenda 10 ditëve nga data e shpalljes së rezultatit vetëm një herë.

2. Për shqyrtimin e ankesave, Ministri i Mbrojtjes krijon një komision të posaçëm të drejtuar nga një ushtarak me gradë madhore.

3. Komisioni i ngritur për shqyrtimin e ankesave vendos lënien në fuqi të vlerësimit të komisioneve të karrierës ose ndryshimin e këtij vlerësimi.

4. Procedurat dhe funksionimi i komisionit të shqyrtimit të ankesave përcaktohen me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm.

Neni 29

**Përfundimi i procedurave të gradimit**

Gradimet e radhës bëhen vetëm pas përfundimit të procedurave të shqyrtimit të ankesave nga komisioni, sipas nenit 28 të këtij ligji.

Neni 30

**Ankimi për procedurën e daljes në rezervë/lirim**

1. Për mosmarrëveshjet që lindin për nxjerrjen në rezervë/lirim nga shërbimi ushtarak në Forcat e Armatosura, ushtarakut, përveç atij me gradë madhore, i lind e drejta të ankohet te Ministri i Mbrojtjes brenda 30 ditëve nga data e njoftimit për nxjerrjen në rezervë/lirim.

2. Ministri i Mbrojtjes, brenda 30 ditëve, shqyrton dhe vendos për ankesën.

3. Kur mosmarrëveshja nuk zgjidhet ose organi kompetent nuk e ka shqyrtuar kërkesën në afatin e caktuar në pikën 2, të këtij neni, ushtarakut i lind e drejta të ankohet në gjykatën administrative brenda 30 ditëve.

4. Kur akti i shfuqizuar nga gjykata ka të bëjë me nxjerrjen në rezervë ose në lirim të ushtarakut, ai rikthehet në detyrën e mëparshme ose në një detyrë tjetër të të njëjtit nivel me atë të mëparshmen.

Neni 31

**Rikthimi në shërbimin aktiv**

*( shtuar shkronja "c" e pikës 1 dhe pika 3 me Ligjin nr. 37/2024, datë 18.4.2024)*

1. Ushtarakët në rezervë rikthehen në shërbimin aktiv vetëm në rastet kur:

a) bëhen shtesa në numrin e përgjithshëm të personelit të Forcave të Armatosura;

b) bëhet mobilizimi i përgjithshëm ose i pjesshëm.

c) për nevoja të specialiteteve dhe plotësimin e funksioneve që ndikojnë në ruajtjen e operacionalitetit të Forcave të Armatosura, por jo më shumë se 3 (tre) vjet, me të drejtë rinovimi.

2. Në rastet e rikthimit në Forcat e Armatosura, ushtarakët mbajnë gradën që kishin në çastin e daljes në rezervë.

3. Procedurat, mënyra dhe rregullat për zbatimin e parashikimeve në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes.

Neni 32

**Mospërputhjet gradë-funksion**

*(ndryshuar pika 1, shtuar pika 1/1 me ligjin nr. 15/2021, datë 8.2.2021)*

1. Ushtaraku mund të emërohet në një funksion me një gradë më të ulët, duke mbajtur gradën që ka, por jo për më shumë se 1 (një) vit. Emërimi në një funksion më të ulët sipas kësaj pike nuk mund të kryhet pa kaluar të paktën 3 (tre) vjet nga emërimi i mëparshëm në një funksion me një gradë më të ulët.

1/1. Në rast pëlqimi me shkrim nga vetë ushtaraku, emërimi në një funksion me një gradë më të ulët mund të bëhet më shumë se afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

2. Mospërputhja e gradave me funksionet organike në Forcat e Armatosura nuk duhet të kalojë masën 10 për qind të numrit të përgjithshëm të personelit ushtarak.

KREU IV

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 33

**Zëvendësimi i emërtesave**

Emërtesa “Ushtar me pagesë/Profesionist”, e përdorur në legjislacionin në fuqi, zëvendësohet me emërtesën “Ushtar/Detar”.

Neni 34

**Rregullimi i gradave të ushtarëve**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji:

a) ushtarëve profesionistë I , që kanë më pak se 1 vit kohë qëndrimi në gradë, u jepet grada “Ushtar I/Detar I”;

b) ushtarëve profesionistë I, që kanë më shumë se 1 vit kohë qëndrimi në gradë dhe që kanë përfunduar stërvitjen individuale të avancuar (SIA) u jepet grada “Ushtar II/Detar II”;

c) ushtarëve profesionistë II, që kanë më pak se 1 vit kohë qëndrimi në këtë gradë, u jepet grada “Ushtar II/Detar II”;

ç) ushtarëve profesionistë II, që kanë më shumë se 1 vit kohë qëndrimi në këtë gradë dhe kanë përfunduar SIA-n u jepet grada “Ushtar III/Detar III”;

d) ushtarëve profesionistë II që kanë më shumë se 2 vite kohë qëndrimi në këtë gradë dhe vlerësime “shumë mirë” apo “shkëlqyeshëm” në gradën e ushtarit profesionist u jepet grada “Ushtar IV/Detar IV”.

Neni 35

**Implementimi i daljes në rezervë/lirim**

Zbatimi i neneve 13 dhe 14, të këtij ligji, bëhet duke mos cenuar operacionalitetin dhe gatishmërinë e strukturave të Forcave të Armatosura.

Ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, miraton planin e daljes në rezervë ose lirim të ushtarakëve, kur dalja në rezervë ose lirim sjell cenimin e operacionalitetit dhe gatishmërisë së strukturave të Forcave të Armatosura.

Neni 36
**Referenca e jashtme**

Kudo në legjislacionin në fuqi, ku bëhet referim në ligjin nr. 9171, datë 22.1.2004, "Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", referenca do të konsiderohet e bërë në këtë ligj.

**Dispozita kalimtare**
*(e ligjit nr. 15/2021, datë 8.2.2021)*

1. Brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të gjithë ushtarakët e larguar nga shërbimi aktiv dhe për të cilët nuk ka urdhra përkatës të nxjerrjes në lirim/rezervë, lirohen nga shërbimi aktiv me urdhër të organit kompetent, me efekt nga data e largimit të tyre faktik, të verifikuar me dokumentacion zyrtar në dispozicion të strukturave të Forcave të Armatosura dhe Ministrisë së Mbrojtjes.
2. Të gjithë nëntetarëve, nëntogerëve e togerëve, të cilët kanë konkurruar 2 (dy) herë dhe nuk kanë marrë gradën e radhës, u lind e drejta të aplikojnë edhe një herë tjetër në rast se nuk kanë kaluar moshën maksimale të qëndrimit në shërbimin aktiv, sipas neneve 14 e 14/1 të këtij ligji.

**Dispozitë kalimtare**
*(e ligjit nr. 37/2024, datë 18.4.2024)*

Për shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, aktualisht në detyrë, me marrjen e gradës, sipas përcaktimeve të këtij ligji, koha e qëndrimit në detyrë do të llogaritet nga momenti i emërimit fillestar në këtë pozicion.

Neni 37
**Nxjerrja e akteve nënligjore**
*(ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 37/2024, datë 18.4.2024)*

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 5, të nenit 13, të pikës 3 të nenit 18/1, të pikës 1/1 të nenit 21, të nenit 23 dhe të pikës 3 të nenit 31, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
2. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 9, pika 3; 15, pika 4; 16, pika 4; 18, pika 8; 19, pika 3; 20, pikat 2 dhe 3; 21, pika 1; 22, pika 7, dhe 28, pika 4, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 38
**Shfuqizime**

Ligji nr. 9171, datë 22.1.2004, "Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", shfuqizohet.

Neni 39
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI<br>**Ilir Meta**

Miratuar në datën 12.6.2014